



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 16 Mars 2021

Nr: 147

VENDIM

**PËR MIRATIMIN E LISTAVE SHUMEMËRORE TË PARTISË LËVIZJA
SOCIALISTE PËR INTEGRIM PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN TË DATËS 25
PRILL 2021**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, 67, 72, pikat 1 e 2, dhe 73, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të udhëzimit nr. 1, datë 23.12.2020, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”, dhe të shkronjës “a”, të pikës 4, të nenit 5, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar, pasi shqyrtova kërkesën e depozituar nga Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, për miratimin e listave shumëmemërore të kandidatëve për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021, dhe relacionin e paraqitur nga Sekretari i Përgjithshëm,

V Ë R E J:

Presidenti i Republikës, në mbështetje të neneve 65, pikat 1 dhe 2, 92, shkronja “gj”, e 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të neneve 8, 9, pikat 1 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, me Dekretin nr. 11700, datë 06.09.2020, ka caktuar datën 25 Prill 2021 për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin.

Me vendimin nr. 70, datë 15.2.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, është regjistruar si subjekt zgjedhor, për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021, Partia “Lëvizja Socialiste për Integrim”.

Në bazë të neneve 67 dhe 72, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Partia “Lëvizja Socialiste për Integrim”, ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) dokumentacionin për miratimin e listave shumëmemërore me datë 08.03.2021.



Dokumentacioni i paraqitur përmban:

1. Listat shumemërore për 12 Zonat Zgjedhore; Model - 03
2. Deklaratat e kandidatëve të listave shumemërore, të cilët deklarojnë se gëzojnë të drejtën e votës dhe se pranojnë të kandidojnë si kandidat të listës shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim; Model – 05;
3. Kopje të dokumentit të identifikimit për të gjithë kandidatët e listave shumemërore;
4. Jetëshkrimin për të gjithë kandidatët e listës shumemërore Model – 07;
5. Vërtetimin nga Kuvendi i Shqipërisë, i cili vërteton se Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, zotëron mandat në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë;
6. Formularët e vetëdeklarimit për të gjithë kandidatët, në zbatim të ligjit 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.
7. Deklaratën Model 03/1 për disa kandidatë të cilët kanë planifikuar marrjen/ pranimit donacione.

Në mbështetje të nenit 73 të Kodit Zgjedhor, administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve verifikoi listat shumemërore të kandidatëve për deputet të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim dhe dokumentacionin bashkëngjitur të paraqitur dhe konstatoi se ishte në përputhje me kërkesat e parashikuara nga nenet 67 dhe 72 të Kodit Zgjedhor.

Në përputhje me nenin 5, pika 4, shkronja “a”, të ligjit, nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar kandidatët për deputetë, të subjektit politik Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, kanë depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularët e vetëdeklarimit, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik ku përfshihet dhe funksioni i deputetit.

Nga verifikimi i formularëve të vetëdeklarimit, të kandidatëve për deputetë, rezulton se përveç kandidatëve të poshtëpërmendur, të gjithë kandidatët e tjerë nuk kanë deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar.

1. Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të **z. Ferdinand Selam Aligjoni**, kandidat për deputet, qarku Vlorë, me numër rendor 5, rezulton se ka deklaruar:
 - Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit:

Pikës 1, “*A jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj?*”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur me “Po” duke deklaruar se:



-Me vendimin nr. 276 datë 06.12.1989, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, e ka dënuar për veprën penale, parashikuar nga neni 101/1 i Kodit Penal, për të cilën është vendosur masa e dënimit 6 (gjashtë) muaj heqje lirie.

-Me vendimin nr. 145 datë 07.03.2018, Gjykata e Apelit Vlorë, e ka dënuar për veprën penale, parashikuar nga neni 257/A/1, 47, 50 i Kodit Penal.

Pikës 2, *“A jeni dënuar me burgim me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj, për një çështje penale të pazgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë?”*, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur me “Po” duke deklaruar se:

Gjykata e Torinos, e ka ndaluar për 5 (pesë) ditë verifikim, është dënuar për veprën penale, parashikuar nga neni Artt.74 D.P.R 309/90, 73, 80 D.P.R 309/90 e 110, 56, 575 c.p, për të cilën është vendosur fshirje e akuzës, pas verifikimeve dhe hetimeve. Deklarim i pafajshëm sipas artt. 299 c.p.p.

Pikës 3, *“A keni qenë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj, për kryerjen e një vepre penale?”*, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur me “Po” duke deklaruar se:

Është hetuar/gjykuar nga Gjykata e Torinos, në Itali, për verifikim pas përdorimit të të dhënave personale nga të tretë, për periudhën 22- 27 nëntor 2007, rezultat i së cilës është shpallur pafajësia.

Pikës 4, *“A keni qenë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligj zbatuese, për kryerjen e një vepre penale?”* subjekti vetëdeklarues është përgjigjur me “Po” duke deklaruar se:

Është ndaluar/arrestuar nga Gjykata e Torinos, në Itali, për verifikim pas përdorimit të të dhënave personale nga të tretë, për periudhën 22- 27 nëntor 2007, rezultat i së cilës është shpallur pafajësia.

Pikës 5, *“A është caktuar ndonjëherë ndaj jush masë shtrënguese e sigurisë personale në fuqi ose jo?”* subjekti vetëdeklarues është përgjigjur me “Po” duke deklaruar se:

Është caktuar masë e sigurisë arrest me burg, masë e cila është revokuar, nga Gjykata e Torinos Itali, është dënuar për veprën penale “Codice Penale”, parashikuar nga neni Artt.74D.P.R 309/90, 73, 80D.P.R 309/90 e 110, 56, 575 c.p, për të cilën është vendosur fshirje e akuzës, pas verifikimeve dhe hetimeve. Deklarim i pafajshëm sipas artt. 299 c.p.p., për periudhën 22-27 nëntor 2007.

Pikës 8, *“A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se 1 muaj?”*, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur me “PO”, duke deklaruar se:

Ka jetuar në Torino Itali, për arsye emigracioni për periudhën 1992-1995 si dhe për arsye punësimi për periudhat 1995-1998, 1998-2007, 2007-2011 si dhe 2017-2021.

2.Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të **z. Ilir Faik Oboni**, kandidat për deputet, qarku Berat, me numër rendor 5, rezulton se ka deklaruar:



Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit:

Pikës 1, “*A jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj?*” subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “Po” duke deklaruar se:

Me vendimin nr. 68 datë 17.10.1991, Gjykata e Lartë, e ka dënuar për veprën penale, parashikuar nga neni 28/2 i Kodit Penal Ushtarak, për të cilën është vendosur masa e dënimit përjashtim nga dënimi dhe lihet për edukim pranë kolektivit.

Pikës 4, “*A keni qenë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligj zbatuese, për kryerjen e një vepre penale?*” subjekti vetëdeklarues është përgjigjur me “Po” duke deklaruar se:

Është ndaluar/arrestuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për veprën penale “Kundërshtim të punonjësit të policisë të rendit publik”, për periudhën 12.06.2019 deri më 15.06.2019, rezultat i së cilës është pushim i hetimit me nr. 380 akti, datë 17.02.2020, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, pasi fakti nuk parashikohej si vepër penale me ligj.

Pikës 5, “*A është caktuar ndonjëherë ndaj jush masë shtrënguese e sigurisë personale në fuqi ose jo?*” subjekti vetëdeklarues është përgjigjur me “Po” duke deklaruar se:

Është caktuar masë e sigurisë detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore, masë e cila është revokuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për veprën penale “Kundërshtim i punonjësit të rendit publik”, parashikuar nga neni 236/2, për periudhën 15.06.2019 deri më 17.02.2020, për të cilën është vendosur pushim i hetimit nr. 380 akti, datë 17.02.2020, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, pasi fakti nuk parashikohej si vepër penale nga ligji.

Pikës 8, “*A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se 1 muaj?*”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur me “PO”, duke deklaruar se:

Ka jetuar në Atalanta, Greqi, për arsye emigracioni për periudhën 27.08.1996 deri më 12.11.1996.

3. Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të **z. Erald Shefit Alike**, kandidat për deputet, qarku Gjirokastrë, me numër rendor 5, rezulton se ka deklaruar :

Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit:

Pikës 1, “*A jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj?*” subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “Po” duke deklaruar se:

Me vendimin nr. 25 datë 23.04.2007, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, e ka dënuar për veprën penale, “Kundërshtim i punonjësit të policisë së rendit publik”, parashikuar nga neni 236/2 dhe 48/C,



49 e 51 i Kodit Penal, për të cilën është vendosur masa e dënimit 6 (gjashtë) muaj burgim, konvertuar në 2 (dy) vjet shërbim prove.

Pikës 4, “*A keni qenë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligj zbatuese, për kryerjen e një vepre penale?*” subjekti vetëdeklarues është përgjigjur me “Po” duke deklaruar se:

Është ndaluar/arrestuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, për kundërshtim të punonjësit të policisë të rendit publik, në vitin 2007, rezultat i së cilës është 6 (gjashtë) muaj burgim, konvertuar në 2 (dy) vjet shërbim prove.

Pikës 5, “*A është caktuar ndonjëherë ndaj jush masë shtrënguese e sigurisë personale në fuqi ose jo?*” subjekti vetëdeklarues është përgjigjur me “Po” duke deklaruar se:

Është caktuar masë e sigurisë detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore si dhe arrest me burg, masa të cilat janë revokuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, për kundërshtim të punonjësit të policisë të rendit publik, parashikuar nga neni 236/2 dhe 48/C, 49 e 51 i Kodit Penal, në vitin 2007, rezultat i së cilës është 6 (gjashtë) muaj burgim, konvertuar në 2 (dy) vjet shërbim prove.

4. Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të **z. Ashim Hysen Tafilaku**, kandidat për deputet, qarku Shkodër, me numër rendor 9. rezulton se ka deklaruar :

Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit:

Pikës 1, “*A keni jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj?*” subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “Po” duke deklaruar se:

Me vendimin nr. 1867 datë 18.07.2014, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e ka dënuar për veprën penale të parashikuar nga neni 197 dhe 406/1 i Kodit Penal, për të cilën është vendosur masa e dënimit 40.000 (dyzetë mijë) lekë gjobë.

Pikës 7, “*A është marrë ndonjëherë për ju masa e dëbimit nga një shtet i huaj?*” subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “Po” duke deklaruar se:

Është marrë masë dëbimi nga Brescia, Itali, për shkak të mungesës të dokumentacionit, për të cilën është dëbuar në vitin 2007, për një afat 5 (pesë) vjet.

Pikës 8, “*A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se 1 muaj?*”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur me “PO”, duke deklaruar se:

- Ka jetuar në Brescia, Itali, për arsye emigracioni për periudhën 2004-2007.
- Ka jetuar në Pirgu Ilia, Greqi, për arsye emigracioni për periudhën 1998-2000.



5. Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të **z. Sokol Rexhep Ponari**, kandidat për deputet, qarku Tiranë, me numër rendor 20. rezulton se ka deklaruar :

Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit:

Pikës 1, “*A jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj?*” subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “Po” duke deklaruar se:

Me vendimin nr. 2582 datë 04.11.2014, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e ka dënuar për veprën penale të parashikuar nga neni 236/1 i Kodit Penal, ligji nr. 7895 datë 27.01.1995, për të cilën është vendosur masa e dënimit 2 (dy) muaj burgim konvertuar me 60 (gjashtë dhjetë) orë pune në interes publik.

6. Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të **z. Besnik Tonin Jakaj**, kandidat për deputet, qarku Tiranë, me numër rendor 11, rezulton se ka deklaruar :

Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit:

Pikës 4, “*A keni qënë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e një vepre penale?*” subjekti vetëdeklarues është përgjigjur me “Po” duke deklaruar se:

Është ndaluar/arrestuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për procedimin penal nr. 516 datë 30.03.1999, për veprën penale “Kundërshtim i punonjësit të policisë, kanosjes për shkak të detyrës dhe fyerjes për shkak të detyrës”, parashikuar nga neni 236/2, 238 dhe 239/2 i Kodit Penal, në vitin 1999, rezultat i së cilës është vendimi nr. 214 datë 23.03.2001, pushim i gjyqimit për veprën penale të fyerjes për shkak të detyrës, deklarimin e pafajshëm për veprat penale të kundërshtimit të punonjësit të policisë dhe kanosjes për shkak të detyrës.

Pikës 5, “*A është caktuar ndonjëherë ndaj jush masë shtrënguese e sigurisë personale në fuqi ose jo?*” subjekti vetëdeklarues është përgjigjur me “Po” duke deklaruar se:

- Është caktuar masë e sigurisë detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore, masë e cila është revokuar, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për veprën penale “Kundërshtim të punonjësit të policisë”, parashikuar nga neni 236/2 i Kodit Penal, për periudhën 20.01.2000 deri më 19.12.2000, rezultat i së cilës është deklarimi i pafajshëm për veprën penale të kundërshtimit të punonjësit të policisë.

- Është caktuar masë e sigurisë detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore, masë e cila është revokuar, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për veprën penale “Kanosje për shkak të detyrës”,



parashikuar nga neni 238 i Kodit Penal, për periudhën 20.01.2000 deri më 19.12.2000, rezultat i së cilës është deklarimi i pafajshëm për veprën penale të kanosje për shkak të detyrës.

- Është caktuar masë e sigurisë detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore, masë e cila është revokuar, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për veprën penale “Fyerje për shkak të detyrës”, parashikuar nga neni 239/2 i Kodit Penal, për periudhën 20.01.2000 deri më 19.12.2000, rezultat i së cilës është deklarimi i pushimit të gjykimit për veprën penale të fyerjes për shkak të detyrës.

7. Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të **z. Luan Mersin Rama**, kandidat për deputet, qarku Vlorë, me numër rendor 1. rezulton se ka deklaruar :

Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit:

Pikës 8, “A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se 1 muaj?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur me “Po”, duke deklaruar se:

Ka jetuar në Garmisch-Partekirchen, Gjermani, për arsye studimi pasuniversitare për çështje të sigurisë, për 5 (pesë) muaj, janar 1999 deri më 25 qershor 1999.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të ligjit, nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe Kreut V, paragrafi 2, shkronja “b” dhe paragrafi 3, shkronja “c”, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, me shkresat nr. 1825 prot., datë 09.03.2021 dhe nr. 2024 prot., datë 15.03.2021 (shkresë e dërguar për shkak të ndryshimit të gjenealiteteve të kandidatëve) ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresat nr. 1823 prot., datë 09.03.2021 dhe nr. 2023 prot., datë 15.03.2021 (shkresë e dërguar për shkak të ndryshimit të gjenealiteteve të kandidatëve) ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore për kandidatët për deputetë në Kuvendin e Shqipërisë, të subjektit politik Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, që kanë dorëzuar formularët e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresat nr. 2526/1 prot., datë 11.03.2021 dhe 2729/1 prot., datë 16.03.2021 ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatët e për deputet, të subjektit politik Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, sipas të cilës rezulton se kandidatët për deputet:

- 1. Qarku Vlorë, z. Ferdinant Selam Aligjoni, me numër rendor 5**, në bazë të vërtetimit të gjendjes gjyqësore nr. 17 prot., datë 10.03.2021,
 - Me vendimin nr. 276 datë 06.12.1989, Gjykata e Rrethit Vlorë e deklaroi fajtor për veprën penale të “Vjedhjes së Pasurisë Qytetare”, parashikuar nga neni 101/1 Kodi Penal dhe e dënonte me 6 (gjashtë) muaj heqje lirie.



Rehabilituar në bazë të nenit 69 të Kodit Penal.

- Me vendimin nr. 389 datë 17.06.2016, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, e deklaroi fajtor për veprën penale “Refuzim për deklaram ose mosdeklaram i pasurisë, interesave private të personave të zgjedhur ose nëpunësve publikë ose i çdo personi që ka detyrim ligjor për deklaram”, parashikuar nga neni 257/A/1, 47, 50 Kodi Penal. Neni 406 K.Pr.P dënohet me 80.000 (tetëdhjetë) mijë lekë gjobë.

Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. 145 datë 07.03.2018, vendosi lënien në fuqi të vendimit.

Rehabilituar në bazë të nenit 69 të Kodit Penal.

Referuar deklarameve të kandidatit dhe përgjigjes së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve vërehet se dënimi me 6 (gjashtë) muaj heqje lirie i vitit 1989 përfshihet në sferën e ndalimeve të nenit 2, pika 1, shkronja “ç” të ligjit nr. 138/2015. Periudha e ndalimit referuar nenit 4, pika 4, të ligjit 138/2015, zgjat nga momenti i përfundimit të dënimit me burg, sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë, deri në momentin e rehabilitimit, sipas nenit 69 të Kodit Penal. Referuar të dhënave të disponuara kandidati nuk është në periudhën e ndalimit të kandidimit/ moszgjedhsmërisë.

Referuar deklarameve të kandidatit dhe përgjigjes së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve vërehet se dënimi me gjobë sipas parashikimeve të nenit 257/A/1, 47, 50 Kodi Penal, nuk përfshihet në sferën e ndalimeve të nenit 2, të ligjit nr. 138/2015. Referuar të dhënave të disponuara kandidati nuk është në kushtet e ndalimit të kandidimit/ moszgjedhsmërisë.

- 2. Qarku Berat , z. Ilir Faik Oboni, me numër rendor 5**, në bazë të vërtetimit të gjendjes gjyqësore nr. 17 prot., datë 10.03.2021, me vendimin nr. 54 datë 30.08.1991, Gjykata Ushtarake Berat, e deklaroi fajtor për veprën penale “Shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga neni 106 i Kodit Penal dhe e ka dënuar me 6 (gjashtë) muaj riedukim nëpërmjet punës duke i ndaluar $\frac{1}{4}$ e pagës.

- Me vendimin nr. 68 datë 17.10.1991, Kolegji Ushtarak i Gjykatës së Lartë vendosi, prishjen e vendimit e në bazë të nenit 28/2 Kodi Penal Ushtarak e përjashton atë nga dënimi duke ia lënë për edukim efektivit të repartit ushtarak nr. 3117 Bulqizë.

Rehabilituar në bazë të nenit 69 të Kodit Penal.

Referuar deklarameve të kandidatit dhe përgjigjes së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve vërehet se dënimi pa heqje lirie i vitit 1991 nuk përfshihet në sferën e ndalimeve të nenit 2, pika 1, shkronja “b” të ligjit nr. 138/2015. Referuar të dhënave të disponuara kandidati nuk është në kushtet apo në periudhën e ndalimit të kandidimit/ moszgjedhsmërisë.

- 3. Qarku Gjirokastrë, z. Erald Shefit Alike, me numër rendor 5**, në bazë të vërtetimit të gjendjes gjyqësore nr. 17 prot., datë 10.03.2021,



- Me vendimin nr. 25 datë 23.04.2007, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tepelenë, e ka deklaruar fajtor për veprën penale “Kundërshtim i punonjësit të policisë së rendit publik”, parashikuar nga neni 236/2, 51 i Kodit Penal dhe nenit 406 K.Pr.P e dënon me 6 (gjashtë) muaj burgim.
- Në bazë të nenit 59 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit për pjesën e pavuajtur të dënimit për 2 (dy) vjet me kusht.

Në bazë të nenit 69 të Kodit Penal është rehabilituar.

Referuar deklaramëve të kandidatit dhe përgjigjes së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve vërehet se dënimi me 6 muaj heqje lirie për veprën penale “Kundërshtim i punonjësit të policisë së rendit publik”, parashikuar nga neni 236/2, 51 i Kodit Penal, përfshihet në sferën e ndalimeve të nenit 2, pika 1, shkronja “ç” të ligjit nr. 138/2015. Periudha e ndalimit referuar nenit 4, pika 4, të ligjit 138/2015, zgjat nga momenti i përfundimit të dënimit me burg, sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë, deri në momentin e rehabilitimit, sipas nenit 69 të Kodit Penal. Periudha e ndalimit për këtë kandidat ka përfunduar me datë 23.10.2012. Referuar të dhënave të disponuara kandidati nuk është në periudhën e ndalimit të kandidimit/ moszgjedhsmërisë.

4. Qarku Shkodër, z. Ashim Hysen Tafilaku, me numër rendor 9, në bazë të vërtetimit të gjendjes gjyqësore nr. 7 prot., datë 10.03.2021

- Me vendimin nr. 1867 datë 18.07.2014, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e ka deklaruar fajtor për veprën penale “Organizim i llotarive të palejuara”, parashikuar nga neni 197 i Kodit Penal dhe nenit 406/1 K.Pr.P e dënon 40.000 (dyzetë mijë) lekë gjobë.

Në bazë të nenit 69 të Kodit Penal është rehabilituar.

Referuar deklaramëve të kandidatit dhe përgjigjes së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve vërehet se dënimi me gjobë sipas parashikimeve të nenit 97 të Kodi Penal, nuk përfshihet në sferën e ndalimeve të nenit 2, të ligjit nr. 138/2015. Referuar të dhënave të disponuara kandidati nuk është në kushtet e ndalimit të kandidimit/ moszgjedhsmërisë.

5. Qarku Tiranë, z. Sokol Rexhep Ponari, me numër rendor 20, në bazë të vërtetimit të gjendjes gjyqësore nr. 11 prot., datë 10.03.2021,

- Me vendimin nr. 2582 datë 04.11.2014, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e ka deklaruar fajtor për veprën penale të “Kundërshtimit të punonjësit të policisë së rendit publik”, parashikuar nga neni 236/1 i Kodit Penal dhe nenit 406 K.Pr.P e dënon me 2 (dy) muaj burgim.

Në aplikim të nenit 63 vihet të kryejë një punë me interes publik për një kohë prej 60 (gjashtë dhjetë) orësh.

Në bazë të nenit 69 të Kodit Penal është rehabilituar.



Referuar deklarimeve të kandidatit dhe përgjigjes së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve vërehet se dënimi me gjobë sipas parashikimeve të nenit 236/1, i Kodit Penal, nuk përfshihet në sferën e ndalimeve të nenit 2, të ligjit nr. 138/2015. Referuar të dhënave të disponuara kandidati nuk është në kushtet e ndalimit të kandidimit/ moszgjedhsmërisë.

6. Qarku Vlorë, z. Luan Mersin Rama, me numër rendor 01, në bazë të vërtetimit të gjendjes gjyqësore nr. 17 prot., datë 10.03.2021,

- Me vendimin nr. 682 datë 13.06.1995, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e ka deklaruar fajtor për veprën penale të “Shkeljes së nenit 20 të ligjit nr. 7758 i datës 11.10.1993”, duke e dënuar me 100.000 (njëqind mijë) lekë gjobë.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr..... datë 18.12.1995 ka vendosur prishjen e vendimit nr. 682 datë 13.06.1995 duke vendosur pushimin e çështjes.

Në zbatim të nenit 483/2/B, K.Pr.P “Heqja e shënimeve”, në regjistrimin e gjendjes gjyqësore hiqen dhe shënimet lidhur me B) vendimet e pafajësisë ose të pushimit kur kanë kaluar 10 (dhjetë) vjet nga dita që vendimi ka marrë formë të prerë.

Referuar deklarimeve të kandidatit dhe përgjigjes së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, dhe të dhënave të disponuara vërehet se kandidati nuk është në kushtet e ndalimit të kandidimit/ moszgjedhsmërisë.

7. Qarku Tiranë, z. Besnik Tonin Jakaj, me numër rendor 11, në bazë të vërtetimit të gjendjes gjyqësore nr. 17 prot., datë 10.03.2021,

- Me vendimin nr. 13 datë 20.01.2000, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e ka deklaruar fajtor për veprën penale të “Kundërshtimit të punonjësit të policisë, fyerjes për shkak të detyrës, kanosje për shkak të detyrës”, në bazë të nenit 236/2, 239/2, 238, 55 të Kodit Penal, e dënon me 3 (tre) vjet burgim.
- Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 547 datë 19.12.2000 ka vendor prishjen e vendimit dhe dërgimin për rigjykim po në atë gjykatë me trup gjykues tjetër.

Me vendimin nr. 214 datë 23.03.2001 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendosi pushimin e gjykimit për nenin 239/2 i Kodit Penal dhe deklarimin të pafajshëm për nenet 236/2, 238 të Kodit Penal.

Referuar deklarimeve të kandidatit dhe përgjigjes së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, dhe të dhënave të disponuara vërehet se kandidati nuk është në kushtet e ndalimit të kandidimit/ moszgjedhsmërisë.



Kandidatët e tjerë të listës shumëmemërore, të subjektit politik Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, rezultojnë të padënuar.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë për verifikimin e të dhënave për kandidatët për deputet, të subjektit politik Partia Lëvizja Socialiste për Integrim.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë për verifikimin e të dhënave për kandidatët për deputet, të subjektit politik Partia Lëvizja Socialiste për Integrim.

Referuar ligjit, nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar dhe Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, të dhënat e deklaruar në formularin e vetëdeklarimit dhe informacionit të ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, për kandidatët për deputetë, të subjektit politik Partia Lëvizja Socialiste për Integrim nuk përbëjnë kusht për mosregjistrimin e kandidatëve, për Zgjedhjet për Kuvend, të datës 25 Prill 2021.

Pas verifikimeve përkatëse të kërkesës dhe dokumentacionit në tërësi të listave shumëmemërore të Partisë “Lëvizja Socialiste për Integrim” për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021, konstatoj se dokumentacioni i paraqitur është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 67, 72 dhe 73 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, 67, 72, pikat 1 e 2 dhe 73, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në udhëzimin nr. 1, datë 23.12.2020, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”, dhe në shkronjën “a”, të pikës 4, të nenit 5, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar,



V E N D O S :

1. Miratimin e listave shumemërore të kandidatëve për deputet, të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi për zonat zgjedhore, Qarku Berat, Qarku Dibër, Qarku Durrës, Qarku Elbasan, Qarku Fier, Qarku Gjirokastrë, Qarku Korçë, Qarku Kukës, Qarku Lezhë, Qarku Shkodër, Qarku Tiranë dhe Qarku Vlorë.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI





Lista shumemërore

Levizja Socialiste per Integrim

Qarku Berat

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia
1	Ardit	Petrit	Çela	13/07/1987	M
2	Blenard	Muharrem	Nonaj	19/02/1973	M
3	Esmeralda	Petraç	Qirko	26/07/1963	F
4	Petrit	Leme	Sinaj	27/01/1975	M
5	Ilir	Faik	Oboni	01/05/1964	M
6	Aurela	Tafil	Kalivaçi	10/02/1992	F
7	Lefter	Novrus	Maliqi	10/02/1972	M
8	Esmeralda	Musa	Hoxha	28/04/1978	F
9	Shkëlqim	Hazis	Tafa	05/01/1973	M

Kjo listë mbyllet me numrin rendor 9

Levizja Socialiste per Integrim

Qarku Dibër

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia
1	Hajri	Tahir	Laçi	08/06/1970	M
2	Blendi	Riza	Gurra	31/03/1972	M
3	Luljeta	Femi	Skura	12/12/1974	F
4	Merita	Idris	Hoxha	26/01/1967	F
5	Borbardha	Imer	Kaci	13/07/1996	F
6	Altin	Murat	Koltraka	28/04/1974	M

Kjo listë mbyllet me numrin rendor 6



Lista shumemërore

Levizja Socialiste per Integrim

Qarku Durrës

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia
1	Elona	Adil	Guri	08/03/1983	F
2	Bahri	Fehmi	Shaqiri	08/06/1970	M
3	Enon	Xhevdet	Karapici	09/01/1977	M
4	Shemsi	Selim	Preńczy	21/02/1964	M
5	Kontjana	Vasil	Kuçi	28/06/1986	F
6	Hysni	Sabri	Caca	19/07/1969	M
7	Bujar	Filo	Dhima	14/03/1970	M
8	Rexhina	Mëhill	Leka	29/07/1994	F
9	Gazmir	Fiqiri	Tahiri	08/11/1966	M
10	Ramazan	Halil	Topuzi	18/01/1967	M
11	Berinda	Rifat	Bulku	08/04/1986	F
12	Eraldo	Faik	Luku	09/07/1988	M
13	Durim	Muharem	Hoçja	22/05/1990	M
14	Danjela	Shefqet	Tema	02/06/1981	F
15	Artur	Ismail	Baku	17/12/1973	M

Kjo listë mbyllet me numrin rendor 15

Levizja Socialiste per Integrim

Qarku Elbasan

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia
1	Monika	Ramazan	Kryemadhi	09/04/1974	F
2	Altin	Bardhyl	Toska	23/06/1976	M
3	Ermir	Kujtim	Gjinishi	01/02/1973	M
4	Vladimir	Shaban	Muka	12/03/1956	M
5	Sokol	Petrit	Skura	24/04/1979	M
6	Miranda	Rexhep	Rira	11/03/1981	F
7	Mimoza	Dalip	Trimi	08/11/1967	F
8	Klaudia	Halit	Krasnika	30/07/1988	F
9	Dylber	Qerim	Dervishi	23/02/1987	M
10	Sindi	Gazmend	Laloshi	12/10/2000	F
11	Artur	Rexhep	Topi	27/06/1966	M
12	Franko	Bardhul	Hakilja	28/10/1999	M
13	Sindi	Ilirjan	Qafleshi	01/08/1999	F
14	Saimir	Misir	Kumrija	28/08/1984	M
15	Emirjan	Osman	Mekshi	03/04/1989	M

Kjo listë mbyllet me numrin rendor 15



Lista shumemërore

Levizja Socialiste për Integrim

Qarku Fier

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia
1	Monika	Ramazan	Kryemadhi	09/04/1974	F
2	Kejdi	Fatmir	Mehmetaj	19/05/1993	F
3	Klajdi	Arben	Bogdanaj	03/01/1991	M
4	Arben	Llambri	Çuko	23/04/1966	M
5	Alma	Luftar	Malia	20/05/1974	F
6	Ardian	Medin	Alushi	27/03/1971	M
7	Sariola	Gjergj	Janko	18/06/1992	F
8	Juard	Adrian	Myftaraj	25/11/1996	M
9	Kristian	Thimi	Kina	24/02/1995	M
10	Luisida	Resul	Muho	14/04/1978	F
11	Ëtnor	Qamil	Krakulli	23/12/1979	M
12	Renato	Luan	Basholli	12/10/1993	M
13	Blerta	Fatmir	Progonati	26/08/1984	F
14	Emiljano	Nazmi	Braka	16/02/1992	M
15	Maringlen	Ardjan	Shehaj	18/09/1993	M
16	Migena	Novruz	Idrizaj	31/07/1981	F
17	Sotir	Nasi	Zarka	20/03/1953	M
18	Besmir	Perparim	Gropa	22/03/1988	M

Kjo listë mbyllet me numrin rendor 18

Levizja Socialiste për Integrim

Qarku Gjirokastrë

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia
1	Vangjel	Llambi	Tavo	17/12/1969	M
2	Myrvete	Pajtim	Asqeri	11/04/1982	F
3	Elton	Xhafer	Ismaili	24/03/1983	M
4	Albert	Abedin	Malaj	20/01/1981	M
5	Ërald	Shefit	Alika	19/10/1989	M
6	Freskida	Maksi	Çako	14/11/1986	F

Kjo listë mbyllet me numrin rendor 6



Lista shumemërore

Levizja Socialiste për Integrim

Qarku Korçë

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia
1	Endrit	Vullnetar	Braimllari	16/05/1988	M
2	Gentian	Roland	Çala	03/08/1972	M
3	Brunilda	Kozma	Paskali	05/09/1965	F
4	Petrika	Thomaq	Mele	13/07/1994	M
5	Thanas	Çomo	Poçi	31/01/1962	M
6	Ismeralda	Miri	Seidolli	12/03/1999	F
7	Avni	Ahmet	Spaholli	25/07/1963	M
8	Ergin	Andon	Çikopana	22/07/1988	M
9	Suela	Teki	Dinellari	20/05/1987	F
10	Leons	Selami	Hasani	06/01/1993	M
11	Marjeta	Feim	Biba	20/08/1970	F
12	Pandi	Taqo	Jani	07/03/1993	M

Kjo listë mbyllet me numrin rendor 12

Levizja Socialiste për Integrim

Qarku Kukës

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia
1	Erblin	Dashnor	Bulica	18/07/1995	M
2	Fiqirete	Qamil	Çelaj	27/09/1992	F
3	Arber	Idriz	Arifaj	19/10/1985	M

Kjo listë mbyllet me numrin rendor 3

Levizja Socialiste për Integrim

Qarku Lezhë

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia
1	Viktor	Mark	Tushaj	01/01/1962	M
2	Ërtila	Gjet	Nikolli	27/06/1985	F
3	Petrit	Preng	Gjoni	12/02/1969	M
4	Dila	Preng	Prenga	02/01/1969	F
5	Ded	Mark	Ndreca	19/10/1965	M
6	Adelajda	Lek	Gega	01/12/1994	F
7	Eduart	Kol	Bardhoku	27/08/1975	M
8	Algreta	Qemal	Shabani	08/04/1990	F
9	Emiljano	Dedë	Gjonaj	29/03/1992	M

Kjo listë mbyllet me numrin rendor 9



Lista shumemërore

Levizja Socialiste për Integrim

Qarku Shkodër

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia
1	Agron	Elez	Çela	05/02/1969	M
2	Edmond	Kol	Ndou	06/05/1990	M
3	Lindita	Enver	Reçi	05/01/1967	F
4	Ilir	Sabri	Hyseni	04/07/1970	M
5	Erlinda	Myzafer	Kavaja	10/11/1990	F
6	Melisa	Festim	Brojaj	09/11/2000	F
7	Somela	Fatmir	Radohina	08/11/1992	F
8	Elsidita	Luan	Selaj	05/05/2000	F
9	Ashim	Hysen	Tafilaku	22/10/1978	M
10	Elmira	Nevrus	Zefi	12/11/1986	F
11	Elvis	Sulejman	Metani	03/02/1991	M
12	Jalldyz	Nuri	Kastrati	14/11/1958	F

Kjo listë mbyllet me numrin rendor 12



Lista shumemërore

Levizja Socialiste për Integrim

Qarku Tiranë

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia
1	Monika	Ramazan	Kryemadhi	09/04/1974	F
2	Erisa	Piro	Xhixho	17/05/1985	F
3	Petrit	Kozma	Vasili	04/06/1958	M
4	Klajda	Theodhoraq	Gjoshë	28/07/1983	F
5	Përparim	Islam	Spahiu	27/01/1971	M
6	Edmond	Llazar	Haxhinasto	16/11/1966	M
7	Floida	Fadajev	Kërpaçi	17/05/1994	F
8	Nora	Dod	Malaj	29/11/1964	F
9	Klevi	Bujar	Pojana	25/05/1995	M
10	Silva	Maksim	Caka	25/12/1987	F
11	Besnik	Tonin	Jakaj	10/10/1972	M
12	Aldi	Petrit	Fusha	02/10/1990	M
13	Eriona	Pullumb	Bixha	28/04/1992	F
14	Faik	Nezir	Basha	03/06/1985	M
15	Blerdi	Kastriot	Liçaj	10/03/1979	M
16	Petrit	Ymer	Bara	11/01/1953	M
17	Viron	Nafis	Bezhani	05/06/1958	M
18	Esmeralda	Skender	Demiraj	26/03/1987	F
19	Arben	Haredin	Muçaj	20/04/1972	M
20	Sokol	Rexhep	Ponari	08/11/1969	M
21	Elona	Kostandin	Dhima	23/07/1974	F
22	Etion	Shahin	Joka	26/07/1989	M
23	Lemi	Dervish	Muçaj	22/09/1969	M
24	Melisa	Isuf	Cahani	09/03/1983	F
25	Vojo	Irfan	Bregu	26/04/1975	M
26	Agron	Hysen	Karaj	30/06/1973	M
27	Sara	Ylli	Kau	05/08/2000	F
28	Ardian	Dostan	Hasalami	01/06/1978	M
29	Denis	Met	Hidri	30/06/1989	M
30	Iva	Ferdinant	Çarçiu	15/08/1996	F
31	Erald	Bujar	Kaja	08/09/1982	M
32	Klodian	Shkëlqim	Doka	22/05/1991	M
33	Nikoleta	Ilir	Peti	25/05/2002	F
34	Alert	Murat	Zhurda	21/09/2000	M
35	Arben	Hysni	Rroko	28/07/1969	M
36	Brisida	Ibrahim	Shehaj	18/05/1984	F

Kjo listë mbyllet me numrin rendor

36



Lista shumemërore

Levizja Socialiste për Integrim

Qarku Vlorë

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia
1	Luan	Mersin	Rama	09/03/1966	M
2	Grisejda	Myslym	Myslimi	22/05/1992	F
3	Dhimitraq	Andon	Lapa	12/05/1956	M
4	Dikens	Gjolek	Bushaj	24/03/1987	M
5	Ferdinant	Selam	Aligjoni	17/09/1959	M
6	Liri	Muhamet	Dëma	13/04/1965	F
7	Gjergji	Kozma	Mano	29/06/1969	M
8	Entela	Lutfi	Shkurtaç	17/02/1982	F
9	Anxhela	Shuko	Shenaj	14/02/1995	F
10	Joana	Anesti	Ruçi	22/08/1996	F
11	Ëverton	Bujar	Shehu	23/08/1987	M
12	Ilir	Vilson	Hysi	16/04/1973	M

Kjo listë mbyllet me numrin rendor 12Subjekti Zgjedhor ka: 153 kandidatë